

## BILANCI I PAGESAVE<sup>1</sup>

### Përmbajtja

Llogaria korrente	2
Tregtia e mallrave	3
Tregtia e shërbimeve	3
Të ardhurat dytësore	4
Të ardhurat dytësore	5
Llogaria kapitale	5
Llogaria financiare	5

### Kryesore:

Në tremujorin e parë të vitit 2024:

- Deficiti i llogarisë korrente vlerësohet në rreth 371 milionë euro, i thelluar 3 herë më shumë se një vit më parë;
- Llogaria e shërbimeve vlerësohet në një balancë pozitive prej rreth 629 milionë euro, me rritje në terma vjetorë;
- Investimet e huaja direkte u vlerësuan në 354 milionë euro, në rritje vjetore me 15%;
- Të ardhurat në formën e prurjeve valutore nga emigrantët shënuan 242 milionë euro;
- Stoku i rezervës valutore në fund të periudhës vlerësohet i mjaftueshëm për mbulimin e 6.8 muaj importe në mallra dhe shërbime.

Në tremujorin e parë të vitit 2024, *bilanci i përgjithshëm i pagesave* rezultoi negativ, në rënie të mjeteve të rezervës valutore, rreth 280 milionë euro.

Deficiti i *llogarisë korrente* shënon 371 milionë euro, i zgjeruar në terma vjetorë me rreth 243 milionë euro (ose 3 herë më shumë), në sfondin e përkeqësimit të bilancit tregtar të *mallrave*.

Në kahun pozitiv, kontribut në zbutje të deficitit korrent dha zgjerimi i balancave pozitive në *tregtinë e shërbimeve* dhe në të *ardhurat dytësore* së bashku me ngushtimin e balancës negative të të *ardhurave parësore*.


*Llogaria kapitale* u mbyll me një fluks neto negativ prej 76 milionë euro, kundrejt fluksit neto pozitiv prej 16 milionë euro në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Periudha regjistroi flukse të konsiderueshme dalëse nga sektori privat.

*Shkalla e ekspozimit*<sup>2</sup> të ekonomisë shqiptare vlerësohet në -447 milionë euro kundrejt nivelit prej -112 milionë euro në të njëjtën periudhë në vitin e kaluar.

Flukset hyrëse në *llogarinë kapitale dhe financiare* (përfshirë mjetet e rezervës) shënojnë 361 milionë euro, mjaftueshëm për mbulimin e deficitit korrent në masën 97%.

Në një total prej rreth 156 milionë euro (pa përfshirë mjetet e rezervës) flukset hyrëse neto në llogarinë financiare, reflektojnë kryesisht zgjerimin e detyrimeve neto në formën e *investimeve direkte* (302 milionë euro) dhe të *investimeve të tjera* (14 milionë euro), ndërkohë që *investimet e portofolit* rezultuan në flukse neto dalëse, në rreth 159 milionë euro.

*Rezerva valutore*, në fund të marsit 2024, shënon 5,617 milionë euro, mjaftueshëm për mbulimin e 6.8 muaj importe mesatare vjetore në *mallra dhe shërbime* dhe rreth 415% të *borxhit të jashtëm afatshkurtër*.



Grafik 1. Llogaria korrente dhe flukset financiare neto (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve). Shënim: Flukset financiare neto paraqiten sipas parimit të drejtimit të investimit.

1. Të dhënat janë hartuar bazuar në metodologjinë e FMN "Manuali i Bilancit të Pagesave, Botimi i 6-të". Bilanci i Pagesave (BP) regjistron të gjitha transaksionet ekonomike të ndodhura midis njëzive rezidente dhe jorezidente, gjatë një periudhe të dhënë kohe.  
2. Bilanci i llogarisë korrente së bashku me bilancin e llogarisë kapitale përcakton shkallën e ekspozimit të ekonomisë shqiptare me pjesën tjetër të botës, ndërsa llogaria financiare shpjegon si është financiar ky ekspozim.  
3. Alokimi i SDR është një mënyrë për të plotësuar rezervat valutore të vendeve anëtare të Fondit, duke i lejuar anëtarët të zvogëlojnë varësinë e tyre në borxhin e brendshëm ose të jashtëm për ndërtimin e rezervave. Shqipëria ka përfitur nga alokimi i SDR nga viti 2009.

## LLOGARIA KORRENTE

Gjatë tremujorit të parë 2024, transaksionet korrente u zgjeruan me rreth 12% në terma vjetorë, në një nivel prej rreth 4,977 milionë euro. Deficiti i *llogarisë korrente* vlerësohet në 371 milionë euro, i zgjeruar me rreth 243 milionë euro në terma vjetorë.

Përkeqësimi i *llogarisë korrente* në masë të konsiderueshme u ndikua nga thellimi i deficitit tregtar në mallra. Ky i fundit u zbut në masën 30% nga zgjerimi i balancave pozitive në tregtinë e shërbimeve e të ardhurave dytësore së bashku me ngushtimin e balancës negative të të ardhurave parësore.

Deficiti tregtar në mallra u thellua me rreth 345 milionë euro në terma vjetorë dhe reflekton kryesisht përkeqësimin e bilancit tregtar në “mjete transporti” dhe “produkte minerale”, diktuar nga zgjerimi i importeve në “mjete transporti” dhe tkurrja e eksporteve në “produkte minerale”.

Në terma vjetorë, *suficiti tregtar në shërbime* u zgjerua me 12% në nivelin 629 milionë euro, ku shërbimet e udhëtimit, shërbimet e tjera biznesi dhe shërbimet e transportit zgjeruan ndjeshëm balancat e tyre pozitive.

Të ardhurat parësore (*puna dhe kapitali*) rezultojnë në balancë negative prej rreth -61 milionë euro, kundrejt -72 milionë euro në të njëjtën periudhë në vitin e kaluar. Të ardhurat nga investimi (kthimit nga kapitali) zgjeruan balancën negative me rreth 17 milionë euro, ndërkohë flukset neto hyrëse të të ardhurave nga puna janë rritur me +27 milionë euro.

Gjatë periudhës, rreth 88% e shpenzimeve korrente<sup>4</sup> kanë shkuar për financimin e importit të mallrave dhe shërbimeve. Ndërkohë, hyrjet valutore<sup>5</sup> janë siguruar kryesisht nga eksporti i shërbimeve (në masën 59%), si dhe nga eksporti i mallrave dhe transfertave të njëanshme drejt sektorit privat (sëbashku në rreth 32%).

*Në tremujorin e parë 2024, përkeqësimi i deficitit korrent është ndikuar kryesisht nga thellimi i deficitit tregtar në mallra*

	Të dhëna kumulative (4-mujore) për fundin e periudhës, në milionë euro						T1 2023	T1 2024
	T1 2023			T1 2024				
	Bilanci	Kredi	Debi	Bilanci	Kredi	Debi		
<b>Llogaria korrente</b>	945.5	9,005.8	9,951.4	433.8	10,772.9	11,206.8	128.1	371.4
<i>në përputhje ndaj PBB</i>	0.1	0.5	0.5	0.0	0.5	0.5		
<b>Mallra</b>	4,343.9	1,936.8	6,280.6	4,885.1	1,738.8	6,623.9	890.9	1,236.2
<b>Shërbime</b>	2,558.0	5,133.8	2,575.8	3,495.8	6,811.6	3,315.8	564.2	629.1
Shërbime për përpunim të inputeve fizike të zotëruara nga të tjerët	663.0	663.4	0.4	764.1	764.9	0.8	196.2	190.1
Transport	216.9	540.9	324.0	330.1	727.4	397.4	50.2	60.4
Udhëtime	1,173.0	3,055.2	1,882.2	1,916.0	4,337.5	2,421.6	189.5	267.1
Shërbime telekomunikacioni, kompjuteri dhe informacioni	95.6	168.5	72.9	91.8	205.4	113.7	18.4	25.2
Shërbime të tjera biznesi	384.3	494.7	110.5	409.4	551.2	141.8	91.2	111.1
Shërbime dhe mallra qeventare	7.0	50.9	43.8	0.1	44.2	44.1	3.7	6.8
Shërbime të tjera	18.1	160.2	142.1	15.6	180.9	196.5	15.0	18.0
<b>Të ardhura parësore</b>	306.1	629.5	935.6	267.1	820.0	1,087.0	72.1	60.9
Të ardhura nga puna	437.6	469.5	31.9	562.0	598.9	36.8	99.7	127.1
Të ardhura nga investimet	744.2	151.9	896.2	829.3	211.5	1,040.8	171.1	187.8
Investime direkte	682.9	74.9	757.9	799.9	56.5	856.4	164.6	195.7
Investime portofoli	4.8	42.9	47.6	25.7	64.7	38.9	11.8	23.0
Investime të tjera	81.5	9.2	90.7	128.4	17.1	145.5	27.7	36.6
Mjetet e rezervës	24.9	24.9		73.3	73.3		9.3	21.6
Të ardhura të tjera parësore	0.5	8.0	7.5	0.2	9.5	9.4	0.7	0.2
<b>Të ardhura dytësore</b>	1,146.5	1,305.8	159.3	1,222.5	1,402.5	180.0	270.7	296.5
Të ardhura nga emigrantët	863.3	863.3	-	956.3	956.3	-	213.7	241.9

Tabela. Ecuria e përbërësve të bilancit të pagesave (*shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve*)

<sup>4</sup> Shpenzimet korrente përfshijnë importin e mallrave, importin e shërbimeve, daljet në të ardhurat dytësore dhe daljet në të ardhurat dytësore.

<sup>5</sup> Hyrjet valutore përfshijnë eksportin e mallrave, eksportin e shërbimeve, hyrjet në të ardhurat dytësore dhe hyrjet në të ardhurat dytësore.




## TREGTIA E MALLRAVE

Vëllimi i përgjithshëm i tregtisë në mallra u zgjerua me 8% në terma vjetorë, në nivelin 2,015 milionë euro. Tregtia në mallra përfaqëson rreth 40% të transaksioneve korrente. Eksporti i mallrave u ngushtua me 20% në terma vjetorë, duke shënuar 390 milionë euro. Rënia më e madhe është vërejtur në eksportet e “lëndëve djegëse”.

Importi i mallrave është zgjeruar me 18% në terma vjetorë dhe shënon 1,626 milionë euro. Rritjen më të madhe e shënuan importet në grupmallrat “mjete transporti”, “metale bazë” dhe “produkte vegjetale”. Ndërkohë, importet në “produkte minerale” kanë regjistruar rënie- e përqëndruar kryesisht në energji elektrike.

Deficiti tregtar në mallra shënon 1,236 milionë euro, i thelluar në terma vjetorë me 39%. Shkalla e mbulimit të importeve nga eksportet vlerësohet në nivelin 24% nga 35% në një vit më parë.



Grafik 2. Ecuria e tregtisë në mallra (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve).

*Deficiti i tregtisë në mallra u thellua me 345 milionë euro dhe shënon 1,236 milionë euro*

## TREGTIA E SHËRBIMEVE

Tregtia ndërkombëtare e shërbimeve u mbyll me një balancë pozitive, prej rreth 629 milionë euro, e zgjeruar në terma vjetorë me rreth 12%.

Vëllimi i transaksioneve tregtare në shërbime u rrit me rreth 15% në terma vjetorë, ndikuar nga shërbimet e udhëtimit dhe ato të transportit, në reflektim të zgjerimit të konsiderueshëm të numrit të udhëtarëve të huaj në Shqipëri. Në të njëjtën kohë, shërbimet e biznesit kanë vijuar zgjerimin e balancës pozitive.

Shërbimet e udhëtimit kanë zgjeruar balancën pozitive në +267 milionë euro, kundrejt nivelit +189 milionë euro, në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Të ardhurat dhe shpenzimet nga shërbimet e udhëtimit u rritën respektivisht me rreth 26% dhe 20%, në terma vjetorë. Kjo ecuri është diktuar, kryesisht, nga rritja e numrit të udhëtarëve.

Gjatë tremujorit të parë 2024, eksporti i shërbimeve të udhëtimit i ka siguruar ekonomisë vendase rreth 788 milionë euro. Nga ana tjetër, udhëtarët rezidentë (shqiptarë dhe të huaj) kanë shpenzuar në udhëtimet e tyre jashtë vendit 521 milionë euro.

Shërbimet e udhëtimit gjenerojnë respektivisht 58% të flukseve valutore në hyrje dhe rreth 71% të shpenzimeve të kategorisë së shërbimeve.



Shërbime të tjera biznesi rezultuan me bilanc pozitiv prej 111 milionë euro, në rritje vjetore prej 22%. Për tremujorin e parë të vitit, flukset valutore hyrëse për ekonominë shqiptarë nën këtë kategori shërbimi, shënuan rreth 145 milionë euro.

Shërbimet e transportit kanë zgjeruar balancën pozitive me rreth 10 milionë euro.

Bilanci pozitiv i shërbimeve për përpunim të inputeve fizike të zotëruara nga të tjerët<sup>6</sup> u vlerësua në 190 milionë euro. Flukset valutore hyrëse të kësaj kategorie ranë në terma vjetorë me 3% në nivelin 190 milionë euro dhe përfaqësojnë shërbime që ekonomia shqiptare i ofron partnerëve të huaj (jorezidentëve) për përpunimin e mallrave të zotëruara prej këtyre të fundit.

## TË ARDHURAT PARËSORE


Llogaria e të ardhurave parësore (puna dhe kapitali) u mbyll me balancë negative prej 61 milionë euro. Flukset hyrëse dhe dalëse, të kësaj kategorie të ardhurash, u rritën respektivisht me 31% dhe 16% kundrejt të njëjtës periudhë të vitit të kaluar.

Të ardhurat neto faktoriale nga puna, të cilat kryesojnë flukset hyrëse të të ardhurave parësore, rezultuan në një fluks neto pozitiv prej 127 milionë euro ose 27% më shumë se në të njëjtën periudhë një vit më parë. Rritja i dedikohet në masën më të madhe rritjes së numrit të punonjësve sezonalë dhe kufitarë jashtë vendit.

Të ardhurat neto nga investimet thelluan balancën negative, në nivelin 188 milionë euro, ose 10% më shumë kundrejt tremujorit të parë të 2023. Investimet direkte mbizotërojnë, si instrument, flukset valutore neto nga investimi. Këtë tremujor, fluksi dalës neto në formën e fitimit të riinvestuar<sup>7</sup> shënon 212 milionë euro nga 183 milionë euro në një vit më parë.

Ndërkohë, pagesat e interesave për huatë shënojnë 41 milionë euro nga 33 milionë euro në një vit më parë.

*Të ardhurat nga puna kanë diktuar ecurinë e ngushtimit të balancës negative të të ardhurave parësore*



Grafik 3. Ecuria e të ardhurave parësore nga investimet (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve).

<sup>6</sup> Këtu përfshihet vëllimi i transaksioneve të kryera nga industria e përpunimit me lëndë të dytë të huaj në vend.


<sup>7</sup> Konform standardit metodologjik—parimit të regjistrimit të dyfishtë të transaksionit, zëri "fitim i riinvestuar", si komponent i investimeve direkte në llogarinë financiare, duhet të regjistrohet edhe në llogarinë e të ardhurave dytësore nga investimet. Ky regjistrim kryhet në masë të njëjtë, por në kahe të kundërta.



## TË ARDHURAT DYTËSORE

Të ardhurat dytësore u vlerësuan në 296 milionë euro. Rreth 82% e të ardhurave dytësore përfaqësohet nga “të ardhurat nga emigrantët”.

Prurjet valutore të emigrantëve, shënuan rreth 242 milionë euro, në rritje vjetore (13%). Gjatë periudhës, është vërejtur rritje e dërgesave jo vetëm në kanale formale (sistem bankar dhe operatorë të transferimit të parave), por edhe në formën e prurjeve në cash.



Grafik 4. Ecuria e të ardhurave dytësore dhe të ardhurat nga emigrantët (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve).

*Për tremujorin e parë të vitit 2024, prurjet valutore nga emigrantët vlerësohen në rreth 242 milionë euro*

## LLOGARIA KAPITALE

Për tremujorin e parë të vitit, llogaria kapitale u mbyll me një fluks neto negativ prej - 76 milionë euro, kundrejt fluksit neto pozitiv 16 milionë euro një vit më parë. Kjo ecuri është diktuar nga rritja e transfertave dalëse të sektorit privat, si edhe rënia e transfertave hyrëse drejt sektorit të qeverisë. Gjatë të njëjtës periudhë të një viti më parë, kjo kategori ka regjistruar flukse të larta hyrëse në formën e granteve qeveritare për mbështetje buxhetore.

## LLOGARIA FINANCIARE

Llogaria financiare (pa përfshirë mjetet e rezervës) rezultoi në një fluks hyrës neto prej rreth 156 milionë euro, krahasimisht me fluksin hyrës prej 127 milionë euro, të regjistruara në të njëjtën periudhë në 2023.

Flukset hyrëse neto në llogarinë financiare, reflektojnë kryesisht zgjerimin e detyrimeve neto në formën e investimeve direkte (prej rreth 302 milionë euro) dhe të investimeve të tjera (prej rreth 14 milionë euro), ndërkohë që investimet e portofolit rezultuan në fluks neto dalës (prej rreth 159 milionë euro).


Flukset hyrëse jo borxh krijuese në formën e investimeve të huaja direkte shënuan 353 milionë euro, në rritje vjetore rreth 9%. Më tej, marrëdhëniet e borxhit mes kompanive të lidhura nën një marrëdhënie të investimit direkt, rezultuan me një fluks hyrës prej 0.9 milionë euro (rritje e detyrimeve si instrument borxhi mes kompanive të lidhura).

Për tremujorin e parë të vitit, investimet e huaja direkte u vlerësuan në 354 milionë euro, me rritje rreth 15% në terma vjetorë. Injektimi me kapital të ri shënoi 144 milionë euro, lehtësisht në rritje vjetore rreth 1%. Ndërkohë që, kategoria fitimi i riinvestuar u zgjerua me 15%, në nivelin 209 milionë euro.




Gjatë tremujorit të parë 2024, flukset valutore hyrëse në formën e *investimeve të huaja direkte* ishin të përqendruara kryesisht në pasuri të paluajtshme (në masën 23%), sektorin e ndërmjetësimit financiar (në masën 21%), e hidrokarbureve (në masën 13%), e energjitikës (në masën 5%), si dhe komunikacionit (në masën 5%).

Në të njëjtën kohë, zotërimet tona jashtë - mjetet financiare në formën e *investimeve direkte jashtë* u zgjeruan me 52 milionë euro, ose 0.87 milionë euro më shumë referuar të njëjtës periudhë një vit më parë.



Grafik 5. Llogaria financiare dhe flukset neto sipas kategorive përbërëse (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve)

*Investimet e huaja direkte u vlerësuan në 354 milionë euro, me rritje rreth 15% në terma vjetorë*



Grafik 6. Ecuria e fluksit të investimeve direkte - mjete dhe detyrime (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve)

*Investimet e portofolit* rezultuan në një fluks neto dalës prej 159 milionë euro. Ecuria është kryesisht rrjedhojë e zgjerimit të zotërimeve jashtë të sektorit të *korporatave depozituese* në letra me vlerë të borxhit (me rreth 100 milionë euro). Në të njëjtën kohë, ka vijuar rënia e detyrimeve ndaj jorezidentëve, në drejtim të tkurrjes së ekspozimit të letrave me vlerë të borxhit me 54 milionë euro (si pasojë e rritjes së pjesëmarrjes së bankave rezidente në eurobondin e Qeverisë së Përgjithshme).


Llogaria *investimet e tjera* u mbyll në një fluks neto hyrës prej 14 milionë euro, ku zhvillimet kryesore lidhen me sektorin e *korporatave depozituese*.

Në kahun e zotërimeve tona jashtë, sektori i *korporatave depozituese* ka zgjeruar vendosjet në “*monedha e depozita*” me 140 milionë euro, si dhe rritur portofolin e huasë me 55 milionë euro.

Në kahun e detyrimeve, “*monedha dhe depozita*” të jorezidentëve janë zgjeruar me rreth prej 95 milionë euro. Gjithashtu, sektori i *korporatave depozituese* ka rritur ekspozimin në huamarrje, me rreth 67 milionë euro.

Sektorët e tjerë (korporatat jofinanciare) kanë rritur detyrimet e tyre në “*kredi tregtare dhe paradhënie*”, me rreth 70 milionë euro.





Grafik 7. Ecuria e fluksit të investimeve të portofolit dhe investimeve të tjera – mjete dhe detyrime (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve).

Gjatë tremujorit të parë 2024, mjetet e rezervës ranë me 280 milionë euro, për efekt kryesor reduktimin e tepricave të sistemit bankar dhe pagesave të Qeverisë së Përgjithshme. Rezerva valutore në fund të periudhës shënon 5,617 milionë euro, mjaftueshëm për mbulimin e 6.8 muaj importe mesatare vjetore në mallra dhe shërbime.

*Rezerva valutore në fund të periudhës vlerësohet mjaftueshëm për mbulimin e 6.8 muaj importe mesatare vjetore në mallra e shërbime*



**DEPARTAMENTI I  
STATISTIKAVE  
FINANCIARE**

Selia Qendrore Nr. 1 e Bankës së  
Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr.1,  
Tiranë

Tel: + 355 4 241 93 01  
+ 355 4 241 93 02  
+ 355 4 241 93 03  
+ 355 4 241 94 09  
+ 355 4 241 94 10  
+ 355 4 241 94 11

Fax: + 355 4 241 94 08  
Email: [statistics@bankofalbania.org](mailto:statistics@bankofalbania.org)



*Shënime:*

*Banka e Shqipërisë rezervon të drejtën për të bërë rishikimin e statistikave të publikuara. Në rastin e rishikimeve që sjellin ndryshime të treguesve, Banka e Shqipërisë njihet përdoruesit me faktorët e rishikimit dhe ndikimin përkatës.*

*Gjatë periudhës nuk kanë ndodhur ndryshime në bilancin e pagesave.*

*Për më shumë informacion mbi të dhënat e bilancit të pagesave referojuni linkut të mëposhtëm:*

[https://www.bankofalbania.org/Statistikat/Statistikat\\_e\\_Sektorit\\_te\\_Jashtem/  
Bilanci\\_i\\_Pagesave/Te\\_dhenat\\_kryesore\\_per\\_Bilancin\\_e\\_Pagesave.html](https://www.bankofalbania.org/Statistikat/Statistikat_e_Sektorit_te_Jashtem/Bilanci_i_Pagesave/Te_dhenat_kryesore_per_Bilancin_e_Pagesave.html)